

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Juristët pro e kundër bojkotit: Pagat e administratës duhet të jepen menjëherë! KLGJ e KLP, tejkalim ko mpetencash – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/juristet-pro-e-kunder-bojkotit-pagat-e-administrates-duhet-te-jepen-menjehere-klgj-e-klp-tejkalim-kompetencash/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 13:45:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 13:41:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5c11d41420e87cc088bed9aa74b7f00df5b0b61054b76b5169c970d112846677
TEKSTI	f30ff876aa6efb477053d182c1e2969698a0a01283327c3c5c9094647fd48482
PAMJA	46d8628497b9f2d1850198584bff077658bc63e8e3a44d25c52b7ee6fd36b28

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4877bbb90b2511d77a1b89539d2b3c90e3c58d34ecd47b072847c83281a98a6c
E MËPARSHMJA	b52fc1d6e8ea26acb438d9d5b33f3527eaa61cb6514f909a6499fa9732fb1694
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4877bbb90b2511d77a1b89539d2b3c90e3c58d34ecd47b072847c83281a98a6c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Vendimi i administratës gjyqësore për të bojkotuar seancat ka sjellë kolaps të sistemit pas bllokimit të pagave. Të enjten, në mbledhjen e jashtëzakonshme të gjyqtarëve, u vendos që ministri i Financave, Petrit Malaj, dhe numri dy i tij të kallëzohen në SPAK për shpërdorim detyre.

Por eksperti ligjor Rezart Kthupi pretendon se moslëvrimi i fondit të pagave nga ana e MF është në fakt një vepër penale. Nga ana tjetër ai thotë se bojkotin nuk po e kryejnë magjistratët por administrata gjyqësore, që është në kushte emergjente për tu paguar.

“E vërteta është që gjyqtarët dhe prokurorët vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre. Do të ishte ky version i klasik që gjyqtarët nuk bëjnë dot një gjë vetë, se e kanë të kufizuar, do të nxirrmin administratën shtetërore. Nuk e besoj se është kjo. Administrata gjyqësore është shumë herë më e ndjeshme se gjyqtarët ndaj efekteve financiare, të mospagesës. Fakti penal lidhet me pagat e gjyqtarëve, por me pagat e administratës gjyqësore, se janë pjesa më sensitive. Nëse gjyqtarët dhe prokurorët janë më pak të ndjeshëm, ndërkohë që sekretarët gjyqësorë, nëpunësit, ftuesit janë shumë më tepër”, tha Rezart Kthupi, avokat.

KLJ dhe KLP nuk kanë pse të zbatojnë urdhrin e Gjykatës Kushtetuese, thotë avokati Kujtim Ibraj, pasi nuk kanë në dorë financat e shtetit.

“KLJ dhe KLP kanë dalë jashtë binarëve kushtetues për kompetencat ligjore që ata kanë për indeksimin e pagave. Pagat i bën vetëm Parlamenti. Nuk mundet që KLJ dhe KLP të marrin kompetencat e Parlamentit, sepse ata nuk janë financiarë. Krijohet një projektbuxhet, një komision

Nje vit te mbare per nxenesit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

parlamentar, thirren ekspertët. Edhe GJK, kur është shprehur, i ka lënë detyrë Parlamentit, se këta kujtojnë që duhet të zbatojnë vendimin. Pse duhet ta zbatojnë këta vendimin? KLP dhe KLGJ kanë boll me çfarë të merren”, u shpreh Kujtim Ibraj, avokat.

Të dy juristët pranojnë se vendimi i GJK-së do të duhej të ishte zbatuar nga Kuvendi.

“Një sistem gjyqësor jep vendim për veten e tij në radhë të parë, pastaj për qytetarët. Kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese që e detyron Parlamentin brenda 6 muajve të merrte hapat ligjorë. Ne kemi një histori të habitshme në sjellje të Parlamentit me Gjykatën Kushtetuese, ku GJK merr vendime dhe Parlamenti vazhdon t’i injorojë”, tha Kthupi.

“Vendimi i Gjykatës Kushtetuese do të duhej të ishte zbatuar, sepse është vendim i gjykatës supreme. Ngërçi që është krijuar është ngërç institucional që nuk ka ndodhur ndonjëherë në historinë e drejtësisë shqiptare. Ministria e Financave nuk mund të bllokonte pagat, siç i kanë pasur më përpara, pastaj ngërçin ligjor do të duhej ta zgjidhte Parlamenti. Nuk mund ta bllokosh gjithë pagën, sepse njerëzit kanë kredi, nevoja familjare”, tha Ibraj.

Në shkurt të këtij viti, Gjykata Kushtetuese urdhëroi Kuvendin të miratojë një ligj të ri për pagat e magjistratëve deri më 31 korrik. Parlamenti nuk miratoi asnjë ndryshim dhe, në këtë situatë, KLGJ dhe KLP vendosën të zbatojnë drejtpërdrejt vendimin e Kushtetueses dhe të rrisin pagat e tyre.

/vizionplus.tv

#juristet

#KLGJ

#KLP

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



KRONIKË

Breshëria e plumbave në Mat, kush ishte...

Xhuljana Zhuleku Dje 14:17



KRONIKË

Mesazh me plumba ndaj një gruaje?!...

Xhuljana Zhuleku Dje 12:19



KRONIKË

Shpërthimi me tritol në Shkodër, policia J...

Taulant Halili Dje 00:27



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.